

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Tema: E folmja e Pejës

Mentori:

Prof. asoc. dr. Fridrik DULAJ

Kandidatja:

Suzana FEJZULLAHI

Gjakovë, 2019

ABSTRAKT

Punimi i temës së diplomës është vlerësues dhe ka për qëllim të hulumtojë dhe të perceptojë rëndësinë e të folmes së Pejës dhe ndikimin e saj në gjuhësi dhe dialektologji. Në përshkrimin e temës do të përqendrohemi tek e folmja e Pejës e cila paraqet vazhdimësinë e gegërishtes verilindore.

Për të mbledhur të dhënat për temën e diplomës, janë intervistuar shtatëmbëdhjetë persona të moshave të ndryshme, që kanë lindur dhe jetojnë në qytetin e Pejës. Tetë persona janë të brezit të vjetër, pesë persona të brezit të mesëm dhe katër persona të brezit të ri.

Intervistat e realizuara janë regjistruar me miratimin e tyre, dhe janë shënuar fjalët të cilat më kanë shërbyer si shembuj gjatë punimit të temës së diplomës andaj, nxjerrja e rezultateve nga intervista mund të konsiderohet mjaft e besueshme.

Rezultatet e arritura, tregojnë se në bazë të analizës, e folmja e Pejës ka pas shumë ndikim në zhvillimin dhe pasurimin e dialektit në arealin e Pejës dhe shembujt që janë marr janë analizuar në rrafshin fonetik dhe morfologjik.

Fjalët kyçe: dialektologjia, gegërishtja verilindore, shqipja standarde, fonetika, morfologjia.

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Gjuha si dukuri shoqërore.....	5
3. Fonetika.....	8
3.1. Sistemi i zanoreve	8
3.1.1. Zanorja a	8
3.1.2. Zanorja e	9
3.1.3. Zanorja o	10
3.1.4. Zanorja i	10
3.1.5. Zanorja	11
3.1.6. Zanorja ë	11
3.2. Togjet e zanoreve - ua, ye dhe ie	11
3.3. Sistemi i bashkëtingëlloreve	12
3.3.1. Fonema nj dhe n	12
3.3.2. Fonema r dhe rr	12
3.3.3. Fonema h	13
3.3.4. Fonema k dhe q.....	13
3.3.5. Fonema x dhe z	13
3.3.6. Fonema ç dhe q.....	13
3.3.7. Rotacizmi.....	14
3.4. Grupet e bashkëtingëlloreve.....	14
3.4.1. Grupet e bashkëtingëlloreve gl dhe kl	15
3.5. Rënia e tingujve.....	15
3.5.1. Afereza	15
3.5.2. Sinkopa.....	15
3.5.3. Apokopa	16
3.5.4. Elizioni	16
3.6. Shtesat e tingujve.....	16
3.6.1. Proteza	16

3.6.2. Epenteza.....	16
3.6.3. Epiteza.....	17
4. Morfologjia.....	17
4.1. Emri.....	17
4.1.1. Gjinia e emrit.....	17
4.1.2. Formimi i gjinive.....	18
4.1.3. Shumësi i emrave.....	18
4.1.4. Lakimi i emrit.....	18
4.2. Mbiemri.....	19
4.3. Përemri.....	19
4.3.1. Përemri vetor.....	19
4.3.2. Përemri dëftor.....	19
4.3.3. Përemri pyetës.....	20
4.3.4. Përemri i pacaktuar.....	20
4.3.5. Përemri pronor.....	20
4.4. Folja.....	21
4.4.1. Mënyra dëftore.....	21
4.4.2. Mënyra lidhore.....	22
4.4.3. Mënyra dëshirore.....	22
4.5. Format e pashtjelluara.....	22
4.5.1. Pjesorja.....	22
4.5.2. Paskajorja.....	23
4.5.3. Përcjellorja.....	23
4.6. Ndajfolja.....	23
4.6.1. Ndajfolja e vendit.....	24
4.6.2. Ndajfolja e kohës.....	24
4.6.3. Ndajfolja e mënyrës.....	24
5. Përfundim.....	25
6. Bibliografia.....	30

1. Hyrje

Tema e cila është trajtuar në këtë punim qëndron në mes të dy fushave të gjuhësisë, në mes të dialektologjisë dhe të sociolinguistikës. I përket rrafshit dialektologjik ngase e folmja që është shfaqur gjatë intervistës që kam bërë i takojnë një territori të caktuar, përkatësisht arealit të Pejës. Ndërsa, i përket rrafshit sociolinguistikë ngase kemi trajtuar ndikimin e faktorëve sociolinguistikë në shfaqjen e ndryshimeve në intervistimin e tyre.

Qëllimi i këtij studimi është përshkrimi i të folmes së Pejës. Kjo e folme paraqet vazhdimësinë e gegërishtes verilindore. Është studiuar e folmja e shtatëmbëdhjetë personave të moshave të ndryshme, që kanë lindur dhe jetojnë në qytetin e Pejës. Tetë persona janë të brezit të vjetër, pesë persona të brezit të mesëm dhe katër persona të brezit të ri.

Në punim janë marrë vetëm trajtat që i përkasin dialektit, ato që kemi evidentuar janë analizuar në rrafshin fonetik dhe morfologjikë, duke u vënë në krahasim me trajtat që i përkasin normës së standardit. Analizat e tyre janë bërë duke u bazuar në studimet e mëparshme që janë bërë në këto fusha.

Dijetari i shquar frëng Charl Nodie (Charles Nodier) konsideronte të folmet apo ligjërimet popullore si gjuhë të gjalla e të zhveshura të popullit, ndërsa të folurit “bukur” (standard)- thoshte ai- s’është tjetër veçse një shëmbëlltyrë e tyre apo një “manekin”. Njeriu që nuk ka studiuar të folmet e gjuhës së vet, di vetëm gjysmën e gjuhës.¹

Studimi i dialekteve në rrjedhë të viteve ka ardhur gjithnjë duke u bërë më kompleks e njëherazi edhe më i vlefshëm, krahas studimit të gjuhës letrare standarde që, ndërkaq, edhe ajo ka në bazë një dialekt të një krahine të caktuar.²

Zhvillimi i sotëm i të folmeve popullore dhe përgjithësisht i dialekteve të shqipes nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe kaheve të përgjithshme, kulturore dhe mendore të bashkësisë shoqërore shqiptare shtetërore e më gjerë. Në mënyrë të veçantë ka luajtur rol arsimimi masiv, shtimi i peshës së mjeteve të informimit masiv (shtypi, radio-televizionit) dhe i lirisë së fjalës publike.³

Ndikimi i gjuhës letrare ndihet në të folurit e përditshëm, i cili pëson ndryshime të vazhdueshme, duke u afruar me gjuhën letrare. Proceset e vjetërsisë (arkaizmit) dhe të përtëritjes (rinovimit) të leksikut, por edhe më gjerë të zhvillimeve e shtresëzimeve gjuhësore, nëpër të folmet e krahinave të

¹ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHLBU, Tiranë 2003, fq. 15.

² Po aty, fq. 14.

³ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, SHB Morava, Tiranë, 2009, fq. 162.

ndryshme shqiptare në ditët tona shënojnë ngritjen më të lartë. Drejtimi i përgjithshëm i ndryshimeve dialektore që vihet re në të folmet brenda trojeve shqiptare, është sot afrimi me gjuhën letrare. Në përcaktimin e këtij drejtimi çojnë peshë dy faktorë madhorë: së pari, gjuha letrare shqipe e kohës sonë mishëron në vetvete shfaqjen më të qartë të pritjeve kryesore të zhvillimit të gjuhës shqipe në përgjithësi; së dyti, sepse ndikimi i gjuhës letrare mbi dialektet e të folmet përçohet jo vetëm nëpërmjet shkollës e përgjithësisht arsimimit, por edhe nëpërmjet tërë veprimtarisë së përditshme politike, ekonomike, kulturore e administrative.⁴

2. Gjuha si dukuri shoqërore

Si një sistem shenjash që përdoren për komunikim midis njerëzve, gjuha është një prodhim shoqëror. Ajo përbën hallkën kryesore që lidh individin me shoqërinë. Kjo lidhje është e tillë që, pa komunikim me anë të gjuhës, as nuk mund të mendohet lindja dhe ekzistenca e shoqërisë njerëzore, po ashtu si nuk mund të mendohet jeta e gjuhës jashtë shoqërisë. Gjuha ndryshon në tri boshte: në boshtin kohor (diakronik), në boshtin hapësinor (diatopik) dhe në boshtin social (diastatik).⁵

Siç u cek më lart, gjuha përveç që ndryshon në boshtin kohor dhe hapësinor, ajo ndryshon edhe në boshtin shoqëror. Me studimin e ndryshimeve të gjuhës në boshtin social merret sociolinguistika. E cila, është disiplina që studion ndërlidhjet midis të folurit dhe shoqërisë.⁶

Faktorët shoqërorë që ndikojnë në ndryshimin e gjuhës janë: gjinia (seksi) d.m.th. meshkuj nga një anë dhe femrat nga ana tjetër, pastaj ndarja në grupe sipas moshës: foshnja dhe fëmijë, adoleshentë dhe të rinj, të rritur dhe të moshuar, duke dalluar, sidoqoftë tre breza gjuhësore a më saktë sociolinguistikë: brezi i ri, brezi i mesëm ose aktiv, brezi i vjetër apo sikundër po quhet kohëve të fundit “mosha e tretë”.⁷ Qysh herët në sociologji, pastaj edhe në gjuhësi është folur për një diferencë gjuhësore midis të varfërve dhe të pasurve apo, thënë qartë midis klasave të larta elitare dhe klasave të ulëta. Karakteristikat që individualizojnë klasat mund të jenë të ndryshme si: pasuria, edukata, arsimi, profesioni a mjeshtëria, përfshirja në pushtetin politik dhe në shtresat shoqërore elitare.⁸ Disa ndryshime gjuhësore dalin sipas besimeve fetare përkatëse të anëtarëve të bashkësisë përkatëse.

⁴ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, SHB Morava, Tiranë, 2009, fq. 163-165.

⁵ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi të përgjithshme*, Toena, Tiranë, 2008 fq. 289.

⁶ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, SHB Morava, Tiranë, 2009, fq. 18.

⁷ Po aty, fq. 115.

⁸ Po aty, fq. 122.

Me studimin e gjuhës në boshtin hapësinor merret dialektologjia. Ashtu si në çdo gjuhë tjetër, edhe në gjuhën shqipe, prej ndryshimeve që ka pësuar gjuha kohë pas kohe në krahina të ndryshme, ka arritur të ketë sot një degëzim me dy dialekte, secili dialekt me dy nëndialekte dhe me grupe të folmesh të shkallëve të ndryshimeve.⁹

Të folmet e gjuhës shqipe grupohen në dy dialekte, të cilat gjeografikisht ndahen te lumi Shkumbin. Në të djathtë të lumit shtrihet dialekti verior ose gegërishtja, kurse në të majtë të tij shtrihet dialekti jugor ose toskërishtja. Të dhënat e sotme të dialektologjisë shqiptare të çojnë doemos te ndarja e secilit dialekt në dy nëndialekte: gegërishtja veriore dhe gegërishtja jugore në dialektin gegë dhe toskërishtja veriore dhe toskërishtja jugore në dialektin toskë. Në dialektin verior grupet e të folmeve që bëjnë pjesë janë: gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja verilindore, gegërishtja qendrore dhe gegërishtja e Shqipërisë së Mesme. Brenda dialektit toskë grupe të mëdha të folmesh dallohen vetëm në nëndialektin jugor të tij, dallohen labërishtja dhe çamërishtja.¹⁰

Subjektet që janë kundrim i këtij studimi janë folës nativë të gegërishtes, përkatësisht bëjnë pjesë në arealin e Pejës, që i takon grupit të të folmeve të gegërishtes verilindore.

Pozita - Regjioni i Pejës shtrihet në anën e skajshme perëndimore të Republikës së Kosovës. Në morfostrukturën e relievit dallojmë pjesën e ulët të fushës së Rrafshit të Dukagjinit, në lindje dhe kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna, në veri dhe perëndim.

Peja, si qendër urbane, zë pozitë perëndimore në Gadishullin Ballkanik. Atë e ndan nga bregdeti i Detit Adriatik kompleksi i lartë malor i Alpeve të Kosovës. Barriera malore, e cila e rrethon Pejën nga ana e veriut, ajo e perëndimit dhe e jugut jep përshtypje të një lokaliteti të mbyllur, më pak atraktiv dhe funksional. Këtë përshtypje, në shikim të parë, sikur e dëmton lugina e Lumbardhit (Bistricës) të Pejës, nëpër të cilën Republika e Kosovës realizon lidhje komunikative më të shkurtër me bregdetin malazez në Detin Adriatik.¹¹

Komuna e Pejës kufizohet në perëndim dhe në veri nga Mali i Zi, në lindje nga Komuna e Burimit dhe Komuna e Klinës dhe në jug nga Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Deçanit.

Popullsia - Regjioni i Pejës diferencohet për një rritje të theksuar të popullsisë, sidomos shquhet periudha 1948-1981 me një rritje prej 64.322 banorë, përkatësisht 138%. Rritja e popullsisë në vitin 1981 ka qenë 2.3 herë më e madhe se në vitin 1948. Regjistrimi i fundit në vitin 2011 ka shënuar numrin prej 94.451 banorë ose rreth 18% e popullsisë së Republikës së Kosovës.¹²

⁹ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHLBU, Tiranë, 2003, fq. 151.

¹⁰ Po aty, fq. 152-161.

¹¹ Grup autorësh, *Monografia Peja*, Dukagjini, Pejë, 2017, fq. 23.

¹² Po aty, fq. 34.

Zhvillimi ekonomik - Ekzistenca e familjeve fshatare ishte e lidhur me veprimtari bujqësore. Ndërsa në qytet, familjet e mëdha aktivitet kishin tregtinë dhe zejtarinë. Pushtuesi komunist pasi e realizoi shkatërrimin e pronës private, filloi zbatimin e pronës shtetërore dhe shoqërore. Në fazat e mëvonshme të zhvillimit u themeluan një sërë ndërmarrjesh shoqërore (industriale)

Ekonomia e Pejës me tërë infrastrukturën përcjellëse ishte ndër ekonomitë më të zhvilluara në krahasim me komunat e tjera të Kosovës, duke filluar nga objektet industrial, hoteliere e turistike, industria e drurit, bujqësia, ekonomia e vogël, artizanale dhe zejet tjera.

Tranzicioni i Komunës së Pejës sikurse edhe i Kosovës ishte treguar kompleks dhe i kushtueshëm. Fillon procesi i privatizimit të disa ndërmarrjeve shoqërore duke përfshirë fabrikat e ndryshme. Gjatë privatizimit shumë qendra prodhuese u shndërruan në qendra tregtare, banimi dhe veprimtari të reja.¹³

Peja ishte qytet industrial më me se 10 fabrika, por për momentin ato kryesisht nuk janë aktive. Në Pejë , po zhvillohet me sukses biznesi privat me mëse 4.000 biznese të regjistruara.

Përhapja e shkollave - Para Luftës së Parë Botërore, në Pejë dhe rrethinë funksionuan shumë shkolla fetare kishtarë e mejtepe, sepse shkollat në gjuhën shqipe nuk lejoheshin nga administrata osmane. Shkolla shqipe kishtarë e themeluar nga viti 1872 (nën pullazin e kishës në Pejë).

Pas Revolucionit të Turqve të Rinj, përveç dhjetëra mejtepesh dhe dy medreseve, në Pejë ishte hapur edhe një shkollë rushdije (progjimnaz), ku mësimi ishte i obliguar të mbahej në gjuhën osmane. Mirëpo, në mejtepe shpeshherë ligjërohej në gjuhën shqipe, edhe pse ato kishin karakter fetar. Po në këtë kohë, në vitin 1909 megjithë pengesat e Turqve të Rinj, patriotët shqiptarë të Rrafshit të Dukagjinit, të përkrahur nga Hasan Prishtina, hapën shkollën shqipe në Pejë. Por, kryengritjet e vazhdueshme shqiptare deri në shpërthimin e Luftërave Ballkanike e pamundësuan funksionimin e mirëfilltë të kësaj shkolle. Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, Austro-Hungaria i kushtoj rëndësi hapjes së shkollave shqipe. Kështu, në Guverninë e Përgjithshme ushtarake për Mal të Zi, u hapen shkolla fillore shqipe në Pejë, Gjakovë, Gjurakoc, Baran, Irtznik, Zllakuqan, Strelc dhe Istog. Shkollat ishin nën mbikëqyrjen ushtarake, ndërkaq mësimi në të gjitha lëndët, përveç lëndës së gjuhës gjermane, mbahej në gjuhën shqipe dhe me mësues shqiptarë.

Ndërsa Gjimnazi i Pejës për herë të parë nisi punën në vitin 1912.¹⁴

¹³ Grup autorësh, *Monografia Peja*, Dukagjini, Pejë 2017, fq. 266.

¹⁴ Po aty, fq. 280-282.

3. Fonetika

Aspekti fonetik, është një nga veçoritë që e dallojnë dialektin nga gjuha standarde, në të cilin dalin ndryshimet më të mëdha.

3.1. Sistemi i zanoreve

Gjuha letrare shqipe ka vetëm një seri zanoresh gojore të përberë nga shtatë fonema: /i/, /y/, /e/, /a/, /o/, /u/, /e/, kurse të gjitha të folmet e të dy dialekteve kanë bashkërisht një inventar të përberë prej 22 fonemash zanore, nga të cilat: 8 janë të serisë së zanoreve gojore të shkurtra, 9 janë të serisë së zanoreve gojore të gjata dhe 6 janë të serisë së zanoreve hundore.

Për të nxjerrë në dukje dallimet e të folmeve të shqipes në inventarin e fonemave zanore, zanoret e të dy dialekteve janë të ndara në shtatë areale. Në arealin nr 4 e përbejnë të folmet e gegërishtes verilindore (të folmet e rrethit të Tropojës, ato të pjesës veriore të rrethit të Pukës, ato të Hasit në rrethin e Kukësit dhe të folmet e krahinës së Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit dhe këtu hyn edhe e folmja e Pejës)

Si kudo në gegërishte edhe në këtë të folme nuk e kanë sistemin e tyre zanoren e theksuar **ë**. Ky areal karakterizohet nga një inventar me shtatëmbëdhjetë fonema zanore: gjashtë të serisë së zanoreve gojore të shkurtra, gjashtë të serisë së zanoreve gojore të gjata dhe pesë të serisë zanore hundore.¹⁵

ĩ	ỹ	ũ	i:	y:	u:	ĩ	ỹ	ũ
ě	ǒ		e:	o:		ě	ǎ	
ǎ			a:					

3.1.1. Zanorja a

Përderisa gjuha standarde ka vetëm një zanore **a** gojore, edhe në të folmen e Pejës, si në mbarë gegërishten verilindore, gjatë intervistës që kam bërë me persona të moshave të ndryshme, kam vënë re që zanorja **a** na del si zanore e gjatë, e shkurtër dhe hundore. Gjatë intervistës kam vërejtur zanoren hundore **a**, shqiptohet e buzorëzuar në masa të ndryshme, sa vende-vende arrin t'i afrohet zanores **o**:¹⁶ *â°sht, hâ°na, zâ°ni, â°nderr, kâ°m, bâ°ni.*

¹⁵ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHLBU, Tiranë 2003, fq. 178-181.

¹⁶ Po aty fq. 186.

Zanorja **a** e gjatë na del në këto raste: *ta:shti, gruja:, pla:kë, kna:qem, ba:llkon, ra:hmet, pa:sh, sha:rr, za:ll, ma:ll, fla:k, a:rdh, da:j.*

Zanorja **a** e shkurtër na del në këto raste: *klës, bësh, mërr, pës, shëll, hëber, prëp.*

Zanorja **a** hundore na del në këto raste: *mârtu, nântor, sândalle, bâba, mâbet, ushtâr, çântë, i mâdh, âma, mâc.*

Këta shembuj i kam vërejtur tek personat në e brezit të vjetër.

Ndërsa tek personat të moshës së mesme, nuk kemi hasur në shumë ndryshime nga standardi, sepse janë persona më të shkolluar, por megjithatë kemi hasur në disa shembuj:

Zanorja **a** e gjatë na del në këto raste: *tha:, dua:, pësha:, kuna:t, vlla:, ma:rr.*

Zanorja **a** hundore na del në këto raste: *Zâna, Artân, hâna, nâna, kâm, çâder, lâng, kâfe.*

Ndërsa tek personat e brezit të ri, nuk kemi hasur në ndonjë ndryshim, sepse ata gjithnjë e më shumë po ecin drejt standardit.

3.1.2. Zanorja **e**

Sipas rregullave fonetike, zanorja **e** shqiptohet me një hapje mesatare të gojës. Buzët nuk marrin pjesë në nyjetim, as nuk zgjaten, as nuk rrumbullakohen, as nuk tërhiqen anash. Trupi i gjuhës zhvendoset përpara, ashtu si tek **i-ja**, kështu që hapësira e faringut zgjerohet. Maja e gjuhës është e ulur dhe prek dhëmbët e poshtëm. Pjesa e mesme e shpinës së gjuhës ngrihet mesatarisht drejt qiellzës së fortë.¹⁷ Gjatë intervistës kam vënë re se gjatë shqiptimit të kësaj foneme, kur ajo ndodhet para bashkëtingëlloreve hundore, ajo fiton timbër hundor dhe shqiptohet si më e hapur p.sh. *mëndja, zêmer, dhëmbje, êmri, shëmbull etj.*

Këta shembuj i kam dëgjuar tek personat e brezit të vjetër.

Ndërsa tek personat e brezit të mesëm, nuk kam hasur në shumë shembuj, sepse ata janë duke ecur drejtë standardizimit të gjuhës dhe janë persona të shkolluar, që punojnë nëpër institucione të ndryshme, mirëpo unë jam munduar të nxjerr disa shembuj. Po i përmendim vetëm disa: *fêmën, sêrioz, vjêt, shofër, pëjon, jêtë, vësh etj*

Ndërsa tek brezi i ri nuk kam mundur të gjej ndonjë ndryshim nga standardi, sepse të gjitha përgjigjet i kam marr në gjuhën standarde.

¹⁷ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2004, fq. 44.

3.1.3. Zanorja o

Zanorja **o** karakterizohet si zanore e buzorëzuar, e prapme, e ngritjes së mesme.¹⁸ E tillë ka dalë edhe gjatë realizimit fonetik në intervistën e bërë. Ashtu sikurse në të folmen e Rahovecit dhe mbarë të folmet e shqipes, ajo nuk del e hundorëzuar¹⁹ as në arealin të cilit i takojnë folësit në fjalë p.sh *motër, shkojmë, shoqe, shok, oborr, zog, kos, sonte, ndoshta*.

3.1.4. Zanorja i

Në gjuhën standarde kemi vetëm një zanore gojore **i**. Zanorja **i** shqiptohet me një hapje të vogël të gojës. Trupi i gjuhës shtyhet mjaft përpara, është i mbledhur, kështu që në hapësirën e faringut formohet një hapësirë e madhe rezonuese. Pjesa e përparme dhe e mesme e shpinës së gjuhës janë ngritur lartë në drejtim të qiellzës së fortë, kështu që shtegu që formohet midis qiellzës së fortë dhe gjuhës, është i vogël. Anët e gjuhës ngrihen dhe mbështeten në qiellzën e fortë më shumë se tek të gjitha zanoret e tjera. Maja e gjuhës është e ulur dhe prek dhëmbët e poshtëm. Buzët nuk marrin pjesë në nyjëtimin e kësaj zanoreje: ato nuk mblidhen, as nuk tërhiqen anash.²⁰

Kjo zanore në të folmen e Pejës ashtu sikurse në të folmen e Rahovecit na del si zanore e gjatë tek emrat e përveçëm të gjinisë mashkullore²¹ si p.sh. *Vi:sar, Olti:, Bleri:m, Lulzi:m, Pajti:m, Buri:m, Shpeti:m, Ori:k, Di:on, Di:ar, Alti:n, Etri:t, Grani:t, Astri:t* etj. Gjatë intervistës kam vënë re se, në disa raste, në vend të zanores **i** del zanorja **y** p.sh.: *kryp-kripë, hyp-hip, rryp-rrip, qylym-qilim, zhdryp-zbrit*.

Këtë kalim të zanores **i** tek zanorja **y** e ka edhe e folmja e Rugovës, siç thekson Adem Hajdaraj tek fjalët rrip dhe kripë të ne shqiptohen me **y** sikurse dhe fjalët *qilim, bilbil, biber* etj., sot e gjithë ditën dalin me **y**: *çylym, bylbyl, byber*. Pa dyshim në labializimin e **i**-së në **y**: këtu do të ketë ndikuar ndonjë bashkëtingëllore si: m, b, p e ndonjë tjetër.²²

¹⁸ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2004, fq. 43.

¹⁹ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2016, fq. 87.

²⁰ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2004, fq. 40.

²¹ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 90.

²² A. Hajdaraj, *E folmja e Rugovës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996, fq. 39.

3.1.5. Zanorja u

Zanorja **u** na del si zanore e buzorëzuar, e prapme, e ngritjes së lartë.²³ Në të folmen e Pejës, zanorja **u** e patheksuar, nuk zëvendësohet me ë-në, por bie p.sh.: *vetlla-vetulla, flutra-flutura, petlla-petulla, hekri-hekuri, lepri-lepuri, kumlla-kumbulla*.

Ky ndryshim është vërejtur edhe në të folmen e Rugovës.

3.1.6. Zanorja ë

Zanorja **ë** është zanore e pabuzorëzuar, e mesme, e ngritjes së mesme.²⁴ Sikurse në mbarë gegërishten verilindore edhe në të folmen e Pejës gjatë intervistës, zanorja **ë** nuk është dëgjuar fare në asnjë pozicion, p.sh.: *pleqnia-pleqëria, nantor-nëntor, bojme-bëjme, knojshin-këndojsin, vlla-vëlla, shnet-shëndet, gzim-gëzim, prralla-përralla, puntor-punëtor*.

3.2. Togjet e zanoreve - ua, ye dhe ie

Në të folmen e Pejës, në intervistën që kam bërë, sikurse edhe në të folmet tjera të gegërishtes veriore, grupet e zanoreve **ua, ye** dhe **ie**, janë monoftonguar, duke ruajtur vetëm elementet e para të tyre.

Togu ua – i gjuhës standarde është monoftonguar në të gjitha rastet e përdorimit të tij, p.sh. *gru-grua, dur-duar, martu-martuar, lujm-luajm, msu-mësuar*.

Togu ye – p.sh. *ly-lyer, kcy-kërcyer, kthy-kthyer, dyr-dyer*.

Togu ie dhe je – p.sh. *dhet-dhjetë, mill-miell, dilli-dielli*.

Të dhënat janë rezultat i intervistës me qytetarët e Pejës, që kanë lindur dhe jetojnë në Pejë.

Në qytetin e Pejës mund të dëgjohet togu **ua, ye** dhe **ie**, kryesisht nga ata persona që kanë ardhur nga Rugova p.sh.

Togu **ua**- *grua, krua, ftua, prrua, potkua, spuna, fillua, punua, xhua, barua, çua* etj.

Togu **ye**- *kcy, krye, thye, lye, çye, kapërcyell, dyer, dye* etj.

Togu **ie-je**-*diell, çie, miell, fier, nier, sjell, vjell, tjerr, nxjerr* etj.²⁵

²³ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë 2004, fq. 42.

²⁴ Po aty, fq. 46.

²⁵ A. Hajdaraj, *E folmja e Rugovës*, IAP, Prishtinë, 1996, fq. 42-43.

Kjo dukuri në pikën 28 (që përfaqëson Pejën, pika që është brenda të folmes në shqyrtim), në hartën numër 3 të ADGJSH-së gjendja e togut zanor **ua** është paraqitur e monoftonguar në **u**.²⁶

3.3. Sistemi i bashkëtingëlloreve

Në të folmen e Pejës, si dhe në mbarë dialektin e gegërishtes, në sistemin e bashkëtingëlloreve, dallimet dialektore janë më të pakta se në sistemin e zanoreve. Të folmet janë shumë të afërta, sidomos në inventarin e fonemave bashkëtingëllore. Dallimet më të shumta shfaqen në përbërjen fonematike të fjalëve, kurse dallime në variantet fonetike të fonemave bashkëtingëllore pothuajse nuk ka fare.²⁷ Disa dallime kanë dalë edhe gjatë intervistës që kam bërë.

3.3.1. Fonema nj dhe n

Realizimi fonetik i fonemës **nj** është bashkëtingëllore hundore qiellzore, ndërsa fonema **n** është bashkëtingëllore hundore alveolare.²⁸ Këto dy fonema ruhen mirë në të folmen e Pejës tek brezi i ri, mirëpo tek brezi i vjetër kemi në vend të fonemës **nj** kemi fonemën **n**, p.sh. **ni-një**, *ndonjherë-ndonjëherë*.

Në disa raste kemi të reduktuar fonemën **nj** në **j** mes të fjalës p.sh. *rroja-rrënja, kshtoja-gështenja, thoj-thonj, huj-hunj, të kajj- të këqinjë, shej-shenj*.

Bashkëtingëllorja **nj** ka dhënë grupin nistor **ni** te këto fjalë: *niher-njëherë, ni-një, nimdhet-njëmbëdhjet, niqind-njëqind, nisoj-njësoj, nime-njëmend, pernime-përnjëmend*.

3.3.2. Fonema r dhe rr

Ashtu sikurse në qytetin e Rahovecit edhe në qytetin e Pejës pothuajse çdoherë kur duhet të përdoret bashkëtingëllorja dridhëse **rr**, përdoret bashkëtingëllorja dridhëse **r**.²⁹ p.sh. *rjedhi-rrjedhi, merr-merr, haro-harro, robaqepës-rrobaqepës, kurë-kurrë, ter-terr, var-varr, reze-rreze*.

Shënim: në arealin e Pejës bashkëtingëllorja **r** është ruajtur në të gjitha rastet, kjo bashkëtingëllore dëgjohet si dridhore më e fuqishme, e cila është në mes të **r** dhe **rr**.³⁰

²⁶ Grup autorësh, *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, ASHSH, Napoli 2007, fq. 81.

²⁷ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, ASHSH, Tiranë, 2003, fq. 195.

²⁸ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2004, fq. 91.

²⁹ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP Prishtinë, 2016, fq. 135.

³⁰ Po aty, fq. 136.

3.3.3. Fonema h

Ashtu si në mbarë gegërishten verilindore, grykorja **h**, dëgjohej dobët edhe në të folmen e Pejës, madje në disa raste nuk dëgjohej fare p.sh. *Memet-Mehmet, mabet-muhabet, njo-njoh, ple-pleh, ndimë-ndihmë*. Këta shembuj janë dëgjuar tek personat e brezit të vjetër. Tek brezi i mesëm dhe brezi i ri, nën ndikimin e shqipes standarde, kjo bashkëtingëllore ka filluar të përtërihet p.sh. *zgjohu, hëngri, shoh, ndihmon, Sahadet, Hasan*.

3.3.4. Fonema k dhe q

Fonema **k** është bashkëtingëllore grykore, mbylltore e shurdhët, ndërsa fonema **q** është qiellzore mbylltore e shurdhët.³¹ Në të folmen e Pejës dhe në gegërishten verilindore ku bashkëtingëllorja **q** na del si bashkëtingëllore **k** p.sh. *qetu-këtu, qepë-kepë, kam qenë-jom konë, qenka-koka, qaj-kaj*.

3.3.5. Fonema x dhe z

Fonema **x** është një bashkëtingëllore gjysmëmbylltore alveolare e zëshme, ndërsa fonema **z** është bashkëtingëllore fërkimore e zëshme, alveolare³² të cilat në të folmen e Pejës nuk paraqesin ndonjë ndryshim të madh në raport me të folmet e tjera të gegërishtes. Në këtë rast kemi kalimin nga bashkëtingëllorja **x** në bashkëtingëlloren **z** p.sh. *rxohet-rëzohet, menxi-mezi, xejtari-zejtari, kallxon-kallëzon (tregon), nxona-zura*.

3.3.6. Fonema ç dhe q

Realizimi fonetik i fonemës **ç** është bashkëtingëllore gjysmëmbylltore, paraqiellzore e shurdhët, ndërsa bashkëtingëllorja **q** është qiellzore mbylltore e shurdhët.³³ Në të folmen e Pejës ashtu sikurse në të folmet tjera verilindore bashkëtingëllorja **ç** në shumë raste na del si **q** p.sh. *veç-veq, çka-qa, çashia-qarshia, çika-qika*.

³¹ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH Tiranë, 2004, fq. 92, 89.

³² Po aty, fq. 80-86.

³³ Po aty, fq. 87-90.

3.3.7. Rotacizmi

Rotacizmi është një tipar dallues në mes të toskërishtes dhe gegërishtes. Është një tipar dallues dialektor që ka të bëjë me këmbimin e **n**-së ndërzanore të gegërishtes me dridhësen **r** të toskërishtes.³⁴ Kjo është një dukuri fonetike që e hasim në sistemin emëror dhe foljor. Kjo dukuri në disa raste është e pranishme edhe në të folmen e Pejës p.sh. *pleqnia-pleqëria, kufini-kufiri, dimen-dimër, hina-hyra*.

3.4. Grupet e bashkëtingëlloreve

Grupet e bashkëtingëlloreve në gjuhën shqipe janë: **mb, nd, ngj, ng**.

Në të folmen e Pejës këto grupe bashkëtingëllore janë ruajtur edhe sot e kësaj dite

Grupi mb – *dembel, tombel, mbrij, mbush, mbas, plumb*.

Këtë dukuri e pasqyron edhe ADGJSH i paraqitur në hartën numër 16 në pikën 28 ku flitet për qytetin e Pejës dhe për grupin bashkëtingëllor **mb** ruhet në të gjitha pozicionet si: *mbiell, kumbull, thumb*.³⁵

Grupi nd – *katund, shpindë, ndërroj, ndalu, ndoshta, vend, tund, e shtunde*.

Grupi bashkëtingëllor **nd** - sipas ADGJSH harta numër 17 në pikën 28 ku flitet për qytetin e Pejës, ka përdorim fakultativ të grupit **nd** si: *nder, këndoj, shkund*.³⁶

Grupi ng - *ngushtë, kungull, tung, ngreh*.

Në ADGJSH harta numër 18 dhe pika 28, grupi bashkëtingëllor **ng** në të folmen e qytetit të Pejës që paraqet dallim në pjesën dërmuese të të folmeve të gegërishtes verilindore. Folësit e Pejës e ruajnë këtë grup bashkëtingëllor në të gjitha pozicionet si: *ngushtë, kungull, tung, cung*.³⁷

Grupi ngj – *ngjyj, ngjesh, kingj*.

³⁴ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHLBU, Tiranë 2003, fq. 204.

³⁵ Grup autorësh, ADGJSH I, ASHS, Napoli, 2007, fq. 99.

³⁶ Po aty, fq. 100.

³⁷ Po aty, fq. 101.

3.4.1. Grupet e bashkëtingëlloreve gl dhe kl

Përderisa në gjuhën standarde grupet e bashkëtingëlloreve **gl** dhe **kl** kanë dhënë bashkëtingëlloret qiellzore **gj** e **q**, në të folmen e Pejës kanë dhënë grykoret **g** dhe **k** p.sh. *kesh-qesh, koka-qenka, guha-gjuha, i gat-i gjatë*.

Këto grupe bashkëtingëllore i gjejmë në veprat e shkrimtarëve të vjetër: Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi, Matranga ky fenomen është përmendur tek libri i prof. F. Dulaj.

Grupi **kl**, ndonëse është i pakët ai dëgjohet te fjalët në të folmen e Rahovecit: *kleçkë, klysh, klinikë, klith*, dhe në trup të fjalës *shakloj, siklet* etj, si edhe te fjalët me prejardhje nga gjuhët e huaja: *klan, kler, klimë* etj, kurse për grupin **gl** e hasim te fjalët: *vegla, voglim, bagla* etj.³⁸

3.5. Rënia e tingujve

Edhe në të folmen e Pejës, si në mbarë gegërishten verilindore, dukuria e rënies së tingujve në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, ka prekur edhe këtë të folme.

3.5.1. Afereza

Rënia e tingujve në fillim të fjalës është dukuri e cila ndodh edhe në të folmen e Pejës dhe në mbarë gegërishten si: *Zana-Suzana, Nori-Arbnor, Monda-Rajmonda, Bina-Albina, Beni-Arben*.

3.5.2. Sinkopa

Dukuria e sinkopës apo rënies së një tingulli apo grupi të tingujve në mes të fjalës është vënë re që është e pranishme edhe në të folmen e Pejës: *shtëpi-shpi, kërcejmë-kcejmë, luajme-lujmë, mbrenda-mrenda, ndëgju-ndigu, muhabet-mabet, këndu-knu, çarshija-çashija, duart-durt, gjysmë-gjysë, shqip-ship, çka-ça, Mehmet-Memet, Sahadet-Sadet* etj.

³⁸ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 140.

3.5.3. Apokopa

Rënia e tingujve në fund të fjalës, apo edhe e mbaresave është dukuri që dëgjohej edhe në të folmen e Pejës, është dukuri e përbashkët e të gjitha të folmeve verilindore dhe më e dukshme te fjalët tek të cilat bije zanorja ë e patheksuar si: *shumë-shum, ishte-ish, erdhi-erdh, mollë-moll, shkollë-shkoll, mos-mo, ndëgju-ndi, perqafu-perqaf etj.*

3.5.4. Elizioni

Elizioni është rënia e zanores së patheksuar fundore të një fjale përpara një zanoreje nistore të fjalës që vjen pas. Është karakteristike më tepër e gjuhës së folur, sidomos në ligjërimin e shpejtë. Rënia e tingullit për shkak të elizionit në drejtshkrim shënohet me apostrof,³⁹ kjo dukuri është vërejtur edhe në të folmen e Pejës dhe në mbarë gegërishten si: *t'i mbush, t'i ndreq, m'u rrit, m'u duk, m'u pa.*

3.6. Shtesat e tingujve

Shtesat e tingujve janë vënë në dukje gjatë intervistës që kam bërë

3.6.1. Proteza

Si dukuri fonetike e shtimit të tingujve në fillim të fjalës, ndeshet edhe në të folmen e Pejës si: *ec-hec, pasi-mbasi, tash-qetash, jasht-përjasht, u ulem-u ungem, ambulancë-nabullantë, n'esull-n'tesull etj.*

3.6.2. Epenteza

Epenteza është dukuri e shtimit të tingujve në mes të fjalës e cila, sikurse në të folmet e tjera të shqipes edhe në të folmen e Pejës është e pranishme si: *sqarim-skjarim, pas-mbas, poq-pjek, çdo javë-përgjeth javë etj.*

³⁹ A. Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH Tiranë, 2004, fq. 152.

3.6.3. Epiteza

Epiteza është shtesa e një tingulli ose një grup tingujsh në fund të fjalëve. Edhe në të folmen e Pejës është shfaqur kjo dukuri si: *tash-tashti, kë-kond, kujna-kujt, këtij-ktina, atij-atina* etj.

4. Morfologjia

Në strukturën morfologjike, dallimet tek subjektet që kemi pasur për studim janë njësitë leksiko-gramatikore, si: emri, mbiemri, përemri, folja, të cilat janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës dhe pjesë të pandryshueshme të ligjëratës si: ndajfolja.

4.1. Emri

Emër quhet ajo pjesë e ligjëratës, që emërton qenie të gjalla dhe sende dhe ka kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës dhe të shquarsisë e të pashquarsisë.⁴⁰

Sistemi emëror në të folmen e Pejës, sikundër i tërë sistemi morfologjik, nuk ndryshon aq shumë nga gjuha letrare dhe as nga të folmet e tjera të nëndialektit të gegërishtes verilindore, siç ngjet kjo në sistemin fonetik, ku, siç dihet ndryshimet janë më të mëdha.

4.1.1. Gjinia e emrit

Emrat e gjinisë natyrore mashkullore janë edhe ata emra që marrin mbaresa të emrave femëror dhe lakohen sipas paradigmës së lakimit të tretë. Numri më i madh i këtyre emrave në këtë të folme janë emrat e përveçëm, po ka pak dhe të përgjithshëm që dalin me temë me bashkëtingëllore⁴¹ p.sh. *Shem-Shema, Mus-Musa, Ali-Alia, Xhem-Xhema, bab-baba, daj-daja, koleg-kolega*. Tek të gjithë këta emra në trajtën e pashquar nuk dëgjohet zanorja **ë**. Zanorja **ë**, e trajtës së pashquar, nuk dëgjohet në këtë të folme tek këta emra.

⁴⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 81.

⁴¹ B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2006, fq. 35.

4.1.2. Formimi i gjinive

Emrat që tregojnë frymor në të folmen e Pejës, e formojnë gjininë femërore në të shumtën e rasteve, nga tema e gjinisë mashkullore, duke marrë kryesisht mbaresën **-e** p.sh. *punëtor-punëtore, katundar-katundare, rrobaqepës-rrobaqepëse*.

4.1.3. Shumësi i emrave

Disa emra mashkullor në gjuhën standarde shumësin e bëjnë duke marrë prapashtesën **-ë**, ndërsa në të folmen e Pejës, si në shumë të folme tjera të gegërishtes dalin me mbaresën **-a** p.sh. *doktor-doktora, fotograf-fotografa, shofer-shoferë, nip-nipa, bisht-bishta, kosh-kosha, filxhan-filxhana*.

Në këtë të folme disa emra jofrymorë e formojnë shumësin me mbaresën **-e** p.sh. *katund-katunde, hotel-hotele, kualifikim-kualifikime, vizatim-vizatime, kontribut-kontribute, oborr-oborre, problem-probleme, profesion-profesione, fis-fise, pazar-pazare, gabim-gabime*.

4.1.4. Lakimi i emrit

Në gjuhën shqipe, emrat janë grupuar në katër lakime: në lakimin e parë hyjnë emrat e gjinisë mashkullore, që në rasën emërore të numrit njëjës të trajtës së shquar marrin mbaresën **-i**, lakimi i dytë përfshinë të gjithë emrat që dalin me temë me bashkëtingëlloret **k, g dhe h**, të cilët në rasën emërore, në numrin njëjës të trajtës së shquar marrin mbaresën **-u**, në lakimin e tretë hyjnë emrat e gjinisë femërore që marrin mbaresat **-a** ose **-ja**, ndërsa në lakimin e katërt përfshihen ata me mbaresën **-t** ose **-të**.⁴²

Në të folmen e Pejës në shumicën dërmuese emrat e lakimit të dytë, na dalin si emra të lakimit të parë: p.sh. *shok-shoki-shoku, zog-zogi-zogu, krah-krahi-krahu, burg-burji-burgu*.

	Trajta e pashquar		Trajta e shquar	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
E	Ni zog	Do zogj	Zogi	Zojt
Gj	Ni zogi	Do zogjve	Zogit	Zojve
Dh	Ni zogi	Do zogjve	Zogit	Zojve
K	Ni zog	Do zogj	Zogin	Zojt
Rr	Ni zogi	Do zogjsh	Zogit	Zojve

⁴² Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 112.

4.2. Mbiemri

Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar të sendit dhe përshtatet në gjini dhe numër.⁴³

Mbiemri si kategori leksiko-gramatikore në të folmen e Pejës nuk ka dallime të mëdha as me gjuhën standarde.

Gjatë intervistës kam hasur mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve me temë me zanore, të cilët në këtë të folme marrin prapashtesën **-m** p.sh. i *dishëm, i shoqnushëm, i martum* për gjininë mashkullore, ndërsa për gjininë femërore i shtohet mbaresa **-e** p.sh. e *dishme, e shoqnushme, e martume*.

4.3. Përemri

Përemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emëruar frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuar.⁴⁴

Përemri në të folmen e Pejës, na del i ndryshëm nga standardi.

4.3.1. Përemri vetor

Format e përemrit vetor të vetës së parë njëjës të rasës emërore edhe në të folmen e Pejës na dalin **une** dhe **un** p.sh.⁴⁵ /*Un t'kisha thir me ndejt me mu/, /une jom ardh nuse e re 17 vjeçe/*. Ndërsa në standard është **unë**.

Shumësi në të folmen e Pejës i përemrit vetor, veta e parë del me **na** p.sh./*na jena familje e madhe/*, ndërsa në standard është **ne**.

4.3.2. Përemri dëftor

Sa i përket përemrave dëftor mund të themi se në të folmen e Pejës dhe sidomos në pjesët verilindore qëndrojnë larg mundësisë të afrimit me standardin. Më poshtë po i rendisim disa trajta

⁴³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 153.

⁴⁴ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 215.

⁴⁵ B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2006, fq. 71.

përemërore me parashtesën **q** p.sh. *qaj-qajo, qeky-qekjo, qeta-qeto*, p.sh. */qajo e kish vendin qetu/, /qeky osht ai djali/, /qeto gra kanë me shku/,* ndërsa në standard janë: *ai-ajo, ky-kjo, këta-këto, ata-ato*.

4.3.3. Përemri pyetës

Ky përemër nuk paraqet ndonjë dallim të theksuar morfologjik në raport me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Dallimet që paraqiten janë kryesisht fonetike. Përemrat pyetës që përdoren në këtë të folme janë: *kush? cilli? cilla? çka-qa? pse? sa?*

P.sh./ *Cilla osht ma e zoja?/ /Qa ka për sill sod?// Pse nuk po fol?// Cilli prej juve po vjen me mu?/*

Edhe në të folmen e Pejës sikurse në të folmen e Karadakut, dëgjohen përemrat pyetës të ndërtuar me anë të nyjës së përparme *t'cilit? t'cila? i kujna? e kujna? te kush? i sati? e sata?*⁴⁶

4.3.4. Përemri i pacaktuar

Janë përemra që tregojnë frymor a sende në mënyrë të pacaktuar ose sasi të caktuar të tyre.⁴⁷ Në të folmen e gegërishtes veriore kanë dalë disa përemra të pacaktuar që i mungojnë standardit, të tillë kanë dalë edhe në të folmen e Pejës: p.sh. *kush, asnjo, secili, secilla, kurrkush, cillido, dikush, kondush, gjithkush, do-ca* p.sh./ *ska mujt kurrkush me bo/, /ishin kon do burra/, /cillido prej juve/, /asnjo nuk ish mbet/, /dikush duhet me kon/, /secilla mundet me bo/, /kondush thirre/*

4.3.5. Përemri pronor

Është ai lloj përemri që tregon se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar.⁴⁸ Gjatë intervistës që kam bërë, kam vërejtur disa ndryshime tek përemrat pronor si:

E folmja e Pejës	Gjuha standarde
<i>Jem-jeme</i>	<i>im-ime</i>
<i>Yt-jote</i>	<i>yt-jote</i>
<i>i ktina – i ksej</i>	<i>i tij – e saj</i>
<i>Tonat</i>	<i>ynë-jonë</i>
<i>Juaja</i>	<i>juaj-juaj</i>
<i>i ktyne – i atyne</i>	<i>i saj – e vet</i>

P.sh./ *ni gjys jete e jeme/, /mi ndihmu vetit edhe atyne/ /i ksej osht libri/*

⁴⁶ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 213.

⁴⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 249.

⁴⁸ Po aty, fq. 232.

4.4. Folja

Folje quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një veprim si proces dhe që ka kategorinë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe diatezës.⁴⁹

4.4.1. Mënyra dëftore

4.4.1.1. Koha e tashme

Në te folmen e Pejës sikurse edhe në gjuhën standarde foljet e zgjedhimit të parë në kohën e tashme marrin këto mbaresa vetore: **-j, -n, -n** (në numrin njëjës) dhe **-jmë, -ni, -jnë** (në shumës).⁵⁰

Disa folje të zgjedhimit të dytë me temë me bashkëtingëllore në të folmen e Pejës në vetën e parë të numrit njëjës merr mbaresën **-i** p.sh. *unë foli, ti fol, ai fol, ne folim, ju folni, ata-ato folin*.

Edhe në foljet e zgjedhimit të tretë në të folmen e Pejës, nuk dalin në tri vetat e para të njëjësit me temë zanore sipas standardit, ato dalin me mbaresa vetore p.sh. *unë ha, ti han, ai-ajo han, ne hajm, ju hani, ata-ato hajn*.

4.4.1.2. Koha e pakryer

E pakryera e dëftores është njëra ndër trajtat më të larmishme në të folmet shqipes. Si e tillë haset edhe në të folmen e Pejës e cila merr këto mbaresa vetore: **-sha, -she, -ke, -shim, shit, -shin** p.sh. */zejtarët delshin para dugojve/, /ata i pritshin myshteritë/, /shëgërtat merrshin ujë/, /punojsha në fabrikë/, /knojke shumë bukur/, /shkojshim me shetit/* ndërsa në gjuhën standarde koha e pakryer merr këto mbaresa vetore: **-ja, -je, -te**, ose **-nte** (për njëjësin) dhe **-nim, -nit, -nin** (për shumësin).

4.4.1.3. Koha e kryer

Kjo kohë formohet nga folja ndihmëse në kohën e tashme **kam** (kom) dhe pjesoren e shkurtuar e foljes⁵¹ p.sh. *(un) kom punu, (ti) ki lyp, (ai) ka hup, (ne) kemi vazhdu, (ju) keni lujt, (ata) kanë gabu*. Në të folmen e Pejës folja ndihmëse **kam** ndryshon në dy vetat e para.

⁴⁹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 259.

⁵⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 285.

⁵¹ B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2006, fq. 93.

4.4.1.4. Koha e ardhme

Në të folmen e Pejës dhe në mbarë gegërishten, koha e ardhme formohet me foljen ndihmëse kam + paskajorja p.sh. /*kemi vendos me shku*/, /*kemi me dal*/.

Edhe në këtë të folme sikurse në të folmen e Rahovecit dëgjohej edhe e ardhmja e ndërtuar nga folja **du** dhe pjesorja e gegërishtes me punu p.sh: *Nesër **du** me shku ma heret n'shkollë*.⁵²

4.4.2. Mënyra lidhore

Në të folmen e Pejës, ashtu sikurse në të folmet tjera të gegërishtes verilindore mënyra lidhore formohet me trajtën e lidhore e përbërë nga pjesëza **t** (të) e mënyrës dëftore p.sh. *me t' kallxu, edhe t' lutshin, t' hongrem bukë, t'merrshin me veti, t'ishim lodh, t'kisha thirr, t'ishim shku*.

4.4.3. Mënyra dëshirore

Dëshirorja si mënyrë foljore, e cila ka për qëllim të emërtojë veprimin në formë urimi apo mallkimi,⁵³ edhe në të folmen e Pejës dëgjohej vetëm dy kohë: e tashmja dhe e kryera. Në të folmen e Pejës ashtu si në mbarë të folmet e tjera në Kosovë, koha e tashme merr këto mbaresa: **-fsha, -fsh, -ft**, për njëjësin dhe **-fshim, -fshit, -fshin**, për shumësin.

Ndërsa e kryera e dëshirores formohet nga koha e tashme e foljeve kam dhe jam të dëshirores dhe pjesores së foljes që zgjedhohet p.sh. *paça punu, paçe punu, paçt punu, paçim punu, paçit punu, paçin punu*, ndërsa në standard do të ishte *paça punuar, paç punuar, pastë punuar, paçim punuar, paçi punuar, paçin punuar*.

4.5. Format e pashtjelluara

4.5.1. Pjesorja

Edhe kjo trajtë foljore e pashtjelluar, që merr pjesë në formimin e trajtave të tjera foljore të përbëra, ka variantet e saj dialektore nëpër të folmet e shqipes.

Në këtë rast pjesorja ka dalë pa mbaresa. Ajo përdoret si pjesë përbërëse e kohëve analitike të foljes p.sh. *kom le, jom ardh, kemi mbet, kemi përzi, kom qef etj*.

⁵² F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 245.

⁵³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 329.

Ashtu sikurse në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore edhe foljet që mbarojnë me diftongun **ue** janë monoftonguar në **u** p.sh. *kom meritu, i kom shkollu, kom përjetu, kom punu etj.*

Një karakteristikë e veçantë në të folmen e Pejës është se pjesorja e tipit punu formohet edhe me mbaresën **–nun**. Këtë e kam vërejtur tek disa persona të brezit të vjetër dhe që tashmë nuk përdoret p.sh. *pununun, shkunun, ardhun, këshillunun, konun, lexunun etj.*

4.5.2. Paskajorja

Në të folmen e gegërishtes është tipike paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore **me** dhe nga pjesorja e foljes (me punue).

Edhe në të folmen e Pejës paskajorja është formuar nga pjesëza **me** + pjesorja e foljes p.sh. *me ardh, me punu, me ditë, me dal, me ble.*

Në të folmet e tjera të Kosovës dëgjohen format e paskajores, të cilat ndërtohen duke ia pavendosur pjesëzën - **për** formës së paskajores **me punu** p.sh. *për me punu, për me lexu, për me msu*⁵⁴ etj, të cilat nuk dëgjohen në të folmen e Pejës.

4.5.3. Përcjellorja

Në të folmen e Pejës kjo formë e pashtjelluar e foljes formohet nga pjesorja e foljes dhe pjesëza **tu** p.sh. *tu punu, tu ardh, tu dal etj.* Ndërsa në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore dhe në të folmen e Rahovecit, përcjellorja ndërtohet duke ia pavendosur pjesores së foljes kryesore pjesëzën **tuj** p.sh. *jam tuj lexu, jam tuj msu, jam tuj punu etj.*⁵⁵ Kjo formë e përcjellores nuk dëgjohehet në të folmen e Pejës.

4.6. Ndajfolja

Është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që emërton një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane ose intensitetin e veprimit.⁵⁶

⁵⁴ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 264.

⁵⁵ Po aty, fq. 266.

⁵⁶ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë, 2002, fq. 357.

4.6.1. Ndajfolja e vendit

Në të folmen e Pejës, gjatë intervistës që kam bërë kam hasur në këto ndajfolje të vendit: *kah, kndej, andej, përsipri, lerg, tjetërku, kurku, qendej, qaty, qatje, mrenda*. P.sh. */him mrenda/, /a po din kah po shkon/, /kurku nuk shkova/, /përsipri i lash/, /a t shkojm qendej/, /lerg osht/.*

Format e emëruara të ndajfoljes, të cilat dëgjohen në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore si: *ktuhja, atyhja, çituhja, çatjehja* etj,⁵⁷ nuk mund të dëgjohen në të folmen e Pejës.

4.6.2. Ndajfolja e kohës

Ndajfoljet e kohës nuk paraqesin shumë tipare dalluese në të folmen tonë në krahasim me të folmet e tjera. Gjatë intervistës kam hasur në këto ndajfolje kohe: *pakpare, prom, parprom, mbasneser, përneher, dogri, qetash, maspari* p.sh. */qetash sa erdha/, /pakpare sa fola me to/, /mbasneser kom me shku/, /dogri po qohem/.*

Ndajfoljet e kohës që nuk përdoren në të folmen e Pejës, por përdoren në të folmen e Rugovës janë: *tepasnesri, prema, tepardjeha, atherena ose çatherena, kadit, meiças*.⁵⁸

4.6.3. Ndajfolja e mënyrës

Kemi dëgjuar edhe disa ndajfolje të mënyrës që përdoren në të folmen e Pejës: *kollaj, diqysh, kurqysh, termekt* p.sh. */po shkojke si i termekt/, /kurqysh nuk jom/.*

Ndërsa në të folmen e Rahovecit dëgjohen edhe këto ndajfolje të mënyrës, që nuk dëgjohen në të folmen e Pejës si: *kamaz, gerzhiçt, thiaz, arrzaz, kajstile, thiez*.⁵⁹

⁵⁷ B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2006. fq. 112.

⁵⁸ A. Hajdaraj, *E folmja e Rugovës*, IAP, Prishtinë, 2006, fq. 149.

⁵⁹ F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016, fq. 269.

5. Përfundim

Ky punim ngërthen në vete hulumtimin e të folmes së Pejës. Këtu kam trajtuar dallimet fonetike dhe morfologjike të të folmes së Pejës në krahasim me gjuhën standarde dhe disa të folme të gegërishtes. Dallimet më të mëdha janë shfaqur në sistemin fonetik dhe më pak në sistemin morfologjik.

Në sistemin fonetik dallimet më të mëdha janë shfaqur në sistemin e zanoreve dhe më pak në bashkëtingëllore.

Fonetika

Aspekti fonetik, është një nga veçoritë që e dallojnë dialektin nga gjuha standarde, në të cilin dalin ndryshimet më të mëdha.

Zanorja a duke pasur parasysh që gjuha standarde ka vetëm një zanore **a** gojore, në mbarë gegërishten dhe në të folmen e Pejës zanorja **a** na del si zanore e gjatë, e shkurtër dhe hundore p.sh. **a** e gjatë na del në këto raste si: *ta:shti, gruja:, pla:kë, kna:qem, ba:llkon, ra:hmet, pa:sh, za:ll etj.*

a-hundore na del në këto raste: *mârtu, nântor, sândalle, bâba, mâbet, ushâtr, çântë etj*

a- e shkurtër na del në këto raste: *kâls, bâsh, kâdale, mâr, päs, shâll, hâber, prâp etj.*

Zanorja e na del e hundorëzuar, kur ajo ndodhet para bashkëtingëlloreve hundore, ajo fiton timbër hundor dhe shqiptohet si më e hapur p.sh. *mêritu, mëndja, shêmbull etj*

Zanorja o ashtu sikurse në të folmen e Rahovecit dhe mbarë të folmet e shqipes, ajo nuk del e hundorëzuar as në arealin të cilit i takojnë folësit në fjalë *p.sh motër, shkojmë, shoqe, shok, oborr, zog.*

Zanorja i në gjuhën standarde kemi vetëm një zanore gojore **i**. Kjo zanore në të folmen e Pejës ashtu sikurse në të folmen e Rahovecit na del si zanore e gjatë tek emrat e përveçëm të gjinisë mashkullore *si p.sh. Vi:sar, Olti:, Bleri:m, Lulzi:m, Pajti:m, Buri:m, Shpeti:m, Ori:k, Di:on, Di:ar, Alti:n, Etri:t, Grani:t etj.* Gjatë intervistës kam vënë re se, në disa raste, në vend të zanores **i** del zanorja **y** p.sh.: *kryp-kripë, hyp-hip, rryp-rrip, qylym-qilim, zhdryp-zbrit.*

Zanorja ë sikurse në mbarë gegërishten verilindore edhe në të folmen e Pejës, nuk dëgjohet në asnjë pozicion p.sh: *pleqnija-pleqërija, nantor-nëntor, bojmë-bëjmë, knojshin-këndojshin, vlla-vëlla etj.*

Zanorja u e patheksuar, nuk zëvendësohet me **ë-në**, por bie p.sh. *vetlla-vetulla, flutra-flutura etj.*

Togjet e zanoreve ua ye dhe **ie** janë monoftonguar, duke ruajtur vetëm elementet e para të tyre p.sh. *grua-gru, duar-dur, martuar-martu, dyer-dyr, kthyer-kthy, lyer-ly, miell-mill, diell-dilli etj.*

Në qytetin e Pejës mund të dëgjohej togu *ua, ye dhe ie*, kryesisht nga ata persona që kanë ardhur nga Rugova p.sh.

Togu ua- *grua, krua, ftua, prrua, potkua, spuna, fillua, punua, xhua, fillua, barua, çua etj.*

Togu ye- *kcyë, krye, thye, lye, çye, kapërcyell, dyer, dye etj.*

Togu ie-je-diell, çuell, miell, fier, nier, sjell, vjell, tjerr, nxjerr etj.

Sistemi i bashkëtingëlloreve

Në të folmen e Pejës, si dhe në mbarë dialektin e gegërishtes, në sistemin e bashkëtingëlloreve, dallimet dialektore janë më të pakta se në sistemin e zanoreve. Të folmet janë shumë të afërta, sidomos në inventarin e fonemave bashkëtingëllore.

Bashkëtingëlloret dridhëse **r** dhe **rr** në të folmen e Pejës, pothuajse çdo herë kur duhet të përdoret dridhësja **rr** përdoret bashkëtingëllorja dridhëse **r** p.sh. *rrjedhi-rjedhi, merr-mer, harro-haro, rreze-reze.*

Bashkëtingëllorja h tek brezi i vjetër, pothuajse nuk dëgjohej fare, por tek brezi i mesëm dhe brezi i ri, nën ndikimin e gjuhës standarde, kjo bashkëtingëllore po përtërihet p.sh. *ple-pleh, mabet-muhabet.*

Fonema n-nj-j, edhe bashkëtingëllorja **nj** është reduktuar në bashkëtingëlloren **n** tek brezi i vjetër p.sh. *ni ditë, ndoniherë* dhe bashkëtingëllorja **nj** është reduktuar në **j** p.sh. *kshtoja-gështënja, rroja-rrënj.*

Bashkëtingëllorja k dhe **q**, në të folmen e Pejës, tek brezi i vjetër dhe një pjesë e brezit të mesëm, bashkëtingëllorja **q** kalon në bashkëtingëlloren **k** p.sh. *qepë-kepë, qetu-këtu, qenka-koka, qaj-kaj.*

Fonema x dhe z në të folmen e Pejës nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh në raport me të folmet e tjera të gegërishtes. Në këtë rast kemi kalimin nga bashkëtingëllorja **x** në bashkëtingëlloren **z** p.sh. *rxohet-rëzohet, menxi-mezi, xejtari-zejtari, kallxon-kallëzon (tregon), nxona-zura.*

Grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng, ngj- në të folmen e Pejës janë ruajtur shumë mirë p.sh. *dembel, mbush, mbas, plumb, katund, shpindë, ndalu, ndoshta, vend, ngusht, kungull, tung, ngjy etj*

Grupet e bashkëtingëlloreve gl dhe kl - përderisa në gjuhën standarde grupet e bashkëtingëlloreve **gl** dhe **kl** kanë dhënë bashkëtingëlloret qiellzore **gj** e **qj**, në të folmen e Pejës kanë dhënë grykoret **g** dhe **k** p.sh. *kesh-qesh, koka-qenka, guha-gjuha, i gat-i gjat.*

Morfologjia

Në strukturën morfologjike, dallimet tek subjektet që kemi pasur për studim janë njësitë leksiko-gramatikore, si: emri, mbiemri, përemri, folja, të cilat janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës dhe pjesë të pandryshueshme të ligjëratës si: ndajfolja.

Gjinia e emrit emrat e gjinisë natyrore mashkullore janë edhe ata emra që marrin mbaresa të emrave femëror dhe lakohen sipas paradigmës së lakimit të tretë. Numri më i madh i këtyre emrave në këtë të folme janë emrat e përveçëm, po ka pak dhe të përgjithshëm që dalin me temë me bashkëtingëllore p.sh. *Shem-Shema, Mus-Musa, Ali-Alia, Xhem-Xhema, bab-baba, daj-daja*. Tek të gjithë këta emra në trajtën e pashquar nuk dëgjohej zanorja **ë**. Zanorja **ë**, e trajtës së pashquar, nuk dëgjohej në këtë të folme tek këta emra.

Formimi i gjinive emrat që tregojnë frymor në të folmen e Pejës, e formojnë gjininë femërore në të shumtën e rasteve, nga tema e gjinisë mashkullore, duke marrë kryesisht mbaresën **-e** p.sh. *punëtor-punëtore, katundar-katundare, rrobaqepës-rrobaqepëse*.

Shumësi i emrave disa emra mashkullor në gjuhën standarde shumësin e bëjnë duke marrë prapashtesën **-ë**, ndërsa në të folmen e Pejës, si në shumë të folme tjera të gegërishtes dalin me mbaresën **-a** p.sh. *doktor-doktora, fotograf-fotografia, shofer-shoferë, nip-nipa, bisht-bishta, kosh-kosha, filxhan-filxhana*.

Në këtë të folme disa emra jofrymorë e formojnë shumësin me mbaresën **-e** p.sh. *katund-katunde, hotel-hotele, kualifikim-kualifikime, vizatim-vizatime, kontribut-kontribute, oborr-oborre etj.*

Lakimi i emrit - në të folmen e Pejës në shumicë dërmuese emrat e lakimit të dytë, na dalin si emra të lakimit të parë p.sh. *shok-shoki-shoku, zog-zogi-zogu, krah-krahi-krahu etj.*

Përemri vetor, ndryshimi ka dalë vetëm te veta e parë njëjës *un-une-(unë)*. /*Un t'kisha thir me ndejt me mu/*, /*une jom ardh nuse e re 17 vjeçe/*. Ndërsa në standard është **unë**

Përemri dëftor, kanë dalë disa përemra, të ndryshëm nga standardi si: *qaj-qajo, qeky-qekjo, qeta-qeto*, ndërsa në standard janë: *ai-ajo, ky-kjo, këta-këto, ata-ato*.

Përemri pacaktuar, në të folmen e Pejës kanë dalë disa përemra që i mungojnë standardit: *asnjo, kurrkush, cillido, qeto, asnjoni, njeni etj.* /*ska mujt kurrkush me bo/*, /*ishin kon do burra/*, /*cillido prej juve/*, /*asnjo nuk ish mbet/*, /*dikush duhet me kon/*, /*secilla mundet me bo/*, /*kondush thirre/*

Përemri pronor në të folmen e Pejës na ka dalë në këto forma: *jeme-e jeme, yt-jote, i ktina-i ksej, tanat, juaja, i ktyne-i atyne*; në standard: *im-ime, yt-jote, i tij-e saj, ynë-jonë, juaj-juaj as, i saj-e vet.*

Mënyra dëftore

Koha e tashme - në të folmen e Pejës sikurse edhe në gjuhën standarde foljet e zgjedhimit të parë në kohën e tashme marrin këto mbaresa vetore: **-j, -n, -n** (në numrin njëjës) dhe **-jmë, -ni, -jnë** (në shumës).

Disa folje të zgjedhimit të dytë me temë me bashkëtingëllore në të folmen e Pejës në vetën e parë të numrit njëjës merr mbaresën –i p.sh. *unë foli, ti fol, ai fol, ne folim, ju folni, ata-ato folin*.

Edhe në foljet e zgjedhimit te tretë në të folmen e Pejës, nuk dalin në tri vetat e para të njëjësit me temë zanore sipas standardit, ato dalin me mbaresa vetore p.sh. *unë ha, ti han, ai-ajo han, ne hajm, ju hani, ata-ato hajn*

Koha e pakryer e dëftores është njëra ndër trajtat më të larmishme në të folmet e shqipes. Si e tillë haset edhe në të folmen e Pejës e cila merr këto mbaresa vetore: **-sha, -she, -ke, -shim, shit, -shin** p.sh. */zejtarët delshin para dugojve/, /ata i pritshin myshteritë/, /shëgërtat merrshin ujë/, /shkojshim me shetit/* etj, ndërsa në gjuhën standarde, koha e pakryer merr këto mbaresa vetore: **-ja, -je, -te**, ose **-nte** (për njëjësin) dhe **-nim, -nit, -nin** (për shumësin)

Koha e kryer kjo kohë formohet nga folja ndihmëse në kohën e tashme kam (kom) dhe pjesoren e shkurtuar të foljes p.sh. *(un) kom punu, (ti) ki lyp, (ai) ka hup, (ne) kemi vazhdu, (ju) keni lujt, (ata) kan gabu*. Në të folmen e Pejës folja ndihmëse **kam** ndryshon në dy vetat e para.

Koha e ardhme në të folmen e Pejës dhe në mbarë gegërishten, koha e ardhme formohet me foljen ndihmëse **kam** + paskajorja p.sh. */kemi vendos me shku/*.

Edhe në këtë të folme sikurse në të folmen e Rahovecit dëgjohet edhe e ardhmja e ndërtuar nga folja **du** dhe pjesorja e gegërishtes **me punu** p.sh: *Nesër du me shku ma heret n'shkollë*.

Mënyra dëshirore

Koha e kryer e mënyrës dëshirore, në të folmen e Pejës, na del: *paça punu, paçe punu, paçt punu, paçim punu, paçit punu, paçin punu*; në standard: *paça punuar, paç punuar, pastë punuar, paçim punuar, paçi punuar, paçin punuar*.

Format e pashtjelluara të foljeve si: *pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja* në të folmen e Pejës dhe në mbarë gegërishten na del në forma të ndryshme nga standardi si:

Pjesorja në të folmen e Pejës na del si: *kom punu*, ndërsa në standard është *punuar*. Karakteristikë e veçantë në të folmen e Pejës, tek brezi i vjetër dhe që identifikoheshin si Pejanë është se pjesorja e tipit *punu*, formohet edhe me mbaresën- **nun**, p.sh. *pununun, shkunun, ardhun, lexunun* etj.

Paskajorja - në të folmen e Pejës paskajorja është formuar nga pjesëza **me** + pjesorja e foljes p.sh. *me ardh, me punu, me ditë, me dal, me ble*.

Në të folmet e tjera të Kosovës dëgjoohen format e paskajores, të cilat ndërtohen duke ia pavendosur pjesëzën **për** formës së paskajores **me punu** p.sh *per me punu, per me lexu, per me msu* etj., të cilat nuk janë dëgjuar në të folmen e Pejës.

Përcjellorja në të folmen e Pejës na del si: *tu punu, tu ardhë*, ndërsa në standard është *duke punuar*.

Ndajfolja na del e ndryshuar në disa raste nga standardi si:

Ndajfolja e vendit na del: *kah, kndej, andej, përsipri, lerg, tjetërku, kurku, qandej, qaty, qatje, mrenda* p.sh */përsipri i lash/, /a po din kah po shkon/, /kurku nuk shkova/, /a t'shkojm qandej/, /lerg osht/.*

Ndajfolja e kohës: *pakpare, prom, mbasneser, përneher, dogri, qetash, maspari* p.sh */qetash sa erdha/, /pakpare sa fola me to/, /mbasneser kom me shku/, /dogri po qohem/.*

Ndajfolja e mënyrës na del si: *kollaj, diqysh, kurqysh, termekt* p.sh */po shkoj si i termekt/, /kurqysh nuk jom/.*

Përshkrimi i materialit të incizuar, ka dhënë prova, se brezi i vjetër e ruan dhe flet besnikërisht të folurit nativë, këtu duhet të ketë ndikuar fakti, që subjektet e studimit kanë qenë kryesisht banorë rezident të Pejës. Mirëpo situata paraqitet më ndryshe tek personat e brezit të mesëm dhe të ri, ata gjithnjë e më shumë janë nën ndikim të standardit.

Megjithatë diskutimet e shumta, që bëhen për dallimet e të folmeve, në përfundim të këtij punimi mund të konkludojmë, se të folmet e shqipes po përafrohen mes tyre duke shkuar njëkohësisht drejt standardit.

6. Bibliografia

- I. Anastas Dodi, *Fonetika dhe Fonologjia e Gjuhës Shqipe*, ASHSH, Tiranë 2004.
- II. Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, SHB Morava, Tiranë 2009.
- III. Grup Autorësh, *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe I*, ASHS, Napoli 2007.
- IV. Grup Autorësh, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, ASHSH, Tiranë 2002.
- V. Grup Autorësh, *Monografia Peja*, Dukagjini, Pejë 2017.
- VI. Gjorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHLBU, Tiranë 2003.
- VII. Fridrik Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2016.
- VIII. Adem Hajdaraj, *E folmja e Rugovës*, IAP, Prishtinë 1996.
- IX. Bajram Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP, Prishtinë 2006.
- X. Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi të përgjithshme*, Toena, Tiranë 2008.